



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### RREGULLORE

PËR VARREZAT, OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT, RREGULLIMIN DHE  
MIRËMBAJTJEN E TYRE

Lipjan, 2018

Në bazë të neneve 12 par. 12.2 pika c), 17 dhe 40 par. 40.2 pika a), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 9, 20 dhe 19 par. 19.4 pika a), të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 27. 11. 2018, pas shqyrtimit te propozim Rregullores nga Kryetari i Komunes miratoi këtë:

## RREGULLORE

### PËR VARREZAT, OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT, RREGULLIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E TYRE

#### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.
2. Rregullimi, mirëmbajtja e varrezave dhe varrimi, janë veprimtari komunale të interesit publik.
3. Komuna do të jetë e hapur për të gjitha organizatat dhe indivitet që shprehin vullnetin për të kontribuar në rregullimin e kësaj lëmie të jetës.
4. Asnjë person i vdekur nuk do të mbetet i pavarrosur për shkak të mungesës së rregullativës ligjore, ose procedurave të tjera administartive.

##### Neni 2 Përkufizimet

1. Me këtë Rregullore termat e mëposhtme kanë këto kuptime:
  - 1.1. "Vend-varrezë" nënkuftojmë varrin dhe varrezat familjare;
  - 1.2. "Varr" nënkuftojmë gropën e gërmuar në tokë për të futur të vdekurin (kufomën) ose mbetjet mortore;
  - 1.3. "Varrezë" nënkuftojmë vendin/hapësirën ku varrosen të vdekurit, e cila përfshinë anën e brendshme (hapësira për të futur të vdekurin dhe hapësira tjetër përcjellëse) dhe anën e jashtme e cila përfshinë (hapësira qarkulluese e parkimit dhe e shërbimeve tjera);
  - 1.4. "Varrmihës" nënkuftojmë punëtorin që hap varre në varreza;
  - 1.5. "Varrim" nënkuftojmë ceremoninë e përcjelljes të vdekurit për në varr;
  - 1.6. "Varrhumbur" nënkuftojmë humbjen e varrit, që nuk dihet se ku është varrosur;
  - 1.7. "Kufomë" është trupi i njeriut, pa funksionet jetësore;
  - 1.8. "Shërbim i varrimit" është veprimtaria që zhvillohet nga subjektet publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrimin e kufomës;

- 1.9. "DI" është Drejtorati për Inspektorat;
- 1.10. "DSHP" është Drejtorati për Shërbime Publike;
- 1.11. "Ekshumimi" - zhvarrosje, nxjerra e kufomës nga varri;
- 1.12. "Zhvarrim" është nxjerra e kufomës ose mbetjeve mortore nga varri;
- 1.13. "Zhvarrim i zakonshëm" është zhvarrimi që kryhet pas përfundimit të kohës së prehjes;
- 1.14. "Zhvarrim i jashtëzakonshëm" është zhvarrimi që kryhet para përfundimit të kohës së prehjes, sipas procedurave ligjore, për ekspertizë kriminalistike, për arsyen transferimi në një varr tjetër, pas një periudhe të paracaktuar kohe ose për interes publik;
- 1.15. "Kohë e prehjes" është koha gjatë së cilës nuk lejohet zhvarrimi i zakonshëm i kufomës.

---

### Neni 3

#### Pronësia e varrezave

Varrezat janë toka-prona komunale të cilat janë të përcaktuara me plan zhvillimor urban, me vendim të Kuvendit të Komunës dhe legjislacionit në fuqi dhe që shërbejnë për varrosjen e personave të vdekur.

### Neni 4

#### Sipërfaqet e varrezave

1. Sipërfaqet e varrezave do të janë me këto dimensione:
  - 1.1. varreza të vogla (deri në 00.05,00 ha);
  - 1.2. varreza të mesme (prej 00.05,00 ha deri në 00.20,00 ha) dhe
  - 1.3. varreza të mëdha (mbi 00.20,00 ha)
2. Varrezat duhet t'i përbushin nevojat për varrosjen e të vdekuarve në një vendbanim (fshat), disa vendbanime dhe brenda lagjeve lokale në qytet.

### Neni 5

#### Ndërtimi i varrezave të reja dhe zgjerimi i varrezave të vjetra

1. Ndërtimi i varrezave të reja dhe zgjerimi i varrezave ekzistuese përcaktohet me plan zhvillimor urban, me vendim të Kuvendit të Komunës dhe në bazë të legjislacionit në fuqi.
2. Planin dhe programin për rregullimin e varrezave e përcjell edhe lëshimi i lejes për përdorim.
3. Plani dhe programi përfshinë periudhën së paku 100 vjet për varreza të reja, kurse për zgjerimin e varrezave ekzistuese më së paku 30 vjet me mundësi të zgjerimit në etapa.

### Neni 6

#### Klasifikimi i varrezave

1. Sipas mënyrës së themelimit, respektivisht mënyrës së vdekjes, varrezat klasifikohen në të përgjithshme (publike) dhe të veçanta.
2. Në varreza të veçanta hyjnë: varret me përmendore, varret ushtarake, varret e heronjeve dhe dëshmorëve, varret anonime, varret masovike prej fatkeqësive natyrore dhe varret sipas përkatësisë fetare dhe komplekset e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

#### Neni 7

##### Varri

1. Te përcaktimi i sipërfaqes për varr, duhet llogaritur bruto dhe neto sipërfaqen e varrit.
2. Sipërfaqja neto e varrit, përfshinë parcelën/vendin e varrit.
3. Sipërfaqja bruto e varrit, përfshin neto sipërfaqen e varrit të rritur edhe për distancën në mes varreve.

#### Neni 8

##### Vend varrezat

1. Varrezat duhet vendosur në një vend me sipërfaqe të mjaftueshme, i përshtatshëm sipas konfiguracionit dhe kushteve të lokacionit për varrosje.
2. Vendi i varrezave duhet të jenë jashtë vendbanimit ose afër vendbanimit me qasje në rrugë dykahëshe dhe me shtegun (rrugicë e ngushtë) e ndarë për këmbësorë.
3. Hapësira për varreza duhet t'i përbush këto kriterë:
  - 3.1. Sipas pozitës së varrezave toka duhet të jetë e kulluar, me rreze dhe e qetë, të jenë larg rrjedhave nëntokësore dhe sipërfaqësore të ujërave, jashtë zonave të ujërave të mbrojtura, zonave të cilat vërvshohen nga ujërat;
  - 3.2. Varrezat e reja duhet të jenë së paku 15 m nga rruga publike;

#### Neni 9

##### Plani i varrezave

1. Varrezat planifikohen në mënyrën si vijon:

- 1.1. Vendit të varrit (vetë varri);
- 1.2. Radhët e varrezave të cilën e përbëjnë një mori varresh (varret);
- 1.3. Fushat e varrezave (disa rende të varreve);
- 1.4. Shtegu i cili lidh grupet e varreve me fushën e varreve ose rendin e varreve;
- 1.5. Shtigjet kryesore të cilat lidhin fushat e varreve, me pushimore dhe hapësirën për zgjerim;
- 1.6. Rrugëve interne dhe eksterne (jashtme) për qarkullimin e automjeteve dhe parkimin;
- 1.7. Gjelbërimet (grupore dhe përcjellëse);
- 1.8. Vendi ku bëhet përshtendetja e fundit lamtumirëse, mund të jetë i mbyllur ose i hapur në përputhje me rregullat sipas përkatësisë fetare;

- 1.9. Objektet tjera përcjellëse shërbyese për kufomën (hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare);
- 1.10. Parkingu për automjete.

## **Neni 10** **Dimensionet e varrit**

1. Varri është gropë e varrit me dimensionet si në vijm:
  - 1.1.  $1.00 \times 0.60$  m - deri në moshën 3 vjet;
  - 1.2.  $1.50 \times 0.60$  m –  $1.50 \times 0.75$  m prej moshës 4 vjet deri në moshën 10 vjet ;
  - 1.3.  $1.50 \times 0.70$  m –  $2.50 \times 1.20$  m mbi 11 vjet.
2. Fundi i gropës së varrit sipas grupeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij nenii, duhet të jetë më së paku 50 cm mbi nivelin e pikës më të lartë të ujërave nëntokësore.
3. Thellësia e varrit përcaktohet në bazë të rregullave sipas riteve fetare, e që nuk mund të jetë më e thellë se 180 cm.
4. Dimensionet e varrezave familjare janë  $2.40 \times 2.80$  m, maksimalisht 4 varreza.
5. Mbulesa e varrit mbi kufomë, duhet të bëhet sipas riteve fetare, por jo më shumë se 80 cm.
6. Lartësia e varrezave familjare dhe e përmendoreve mund të jetë më së shumti deri në 2 m. Në to mund të shënohen atributet e personit të vdekur (emri, mbiemri, viti i lindjes dhe i vdekjes).

## **Neni 11** **Renditja e varrezave**

1. Varri mund të bëhet edhe me mur prej betoni ose prej materiali tjeter, duke respektuar dimensionet sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje.
2. Fushat e varrezave përbëhen prej rendeve të varrezave dhe distancës ndërmjet tyre që shërben si shteg për të shkuar deri te varri.
3. Fushat e varrezave duhet të janë të ndara me shtigje kryesore me gjatësi minimale prej 3 m.
4. Shtigjet duhet të janë të ndërtuara prej materialit të fortë pa pengesa për lëvizje dhe jo më të pjerrtë se 8% ndërsa tërthorazi jo më pjerrtë se 1%.

## **Neni 12** **Shërbimet e varrimit**

1. Komuna e Lipjanit me këtë Rregullore obligohet që brenda mundësive dhe kapaciteteve buxhetore të Komunës t'i mbuloj finansiarisht shërbimet e varrimit për të gjithë qytetarët e Komunës.
2. Shërbimet e varrimit do të bëhen konform riteve të komuniteteve fetare dhe kësaj Rregulloreje.

3. Komuna me kérkesë të veçantë të familjarëve të të vdekurit do të mbuloj finansiarisht shërbimin e secilit varrim me shumën e cila do të caktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës nga kategoria e subvacioneve.
4. Kérkesa për mbulim të shërbimeve të varrimit duhet të parashtronhet nga familjarët e të vdekurit në afat prej 30 ditëve nga data e vdekjes e cila është e përcaktuar në faturat e lëshuara.
5. Kérkesa duhet t'i drejtohet Zyrës së Kryetarit të Komunës për mbulim të shërbimeve të varrimit dhe duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni si vijon:
  - 5.1. Çertifikatën e vdekjes
  - 5.2. Kopjen e letërnjoftimit të paraqitësit të kérkesës
  - 5.3. Konfirmimin e llogarisë bankare të familjarit ku do të transferohen mjetet financiare
  - 5.4. Dokumentacionin – faturat mbi kryerjen e shërbimeve të varrimit.
6. Zyra e Kryetarit të Komunës shqyrton kérkesën e parashtruar dhe merr Vendim lidhur me këtë çështje brenda afatit 30 ditor nga dita e parashtrimit të saj.

### **Neni 13 Hapësirat tjera përcjellëse të varrezave**

1. Në pajtim me nenin 9 pika (1.9) të kësaj Rregulloreje, objektet tjera përcjellëse shërbyese hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare), mund të jetë: me thupra metalike me bazament ose material tjetër bashkëkohor, ndërtohen në bazë të një plani të veçantë në pajtim me planin e përgjithshëm të varrezave.
2. Hapësira për qëndrimin e kufomës duhet të jetë e ndërtuar duke pasur parasysh rregullat e riteve fetare të komuniteteve.
3. Parku i automjeteve, duhet të jetë jashtë varrezave dhe i ndarë nga rruga publike.
4. Rrugët e këmbësorëve – shtigjet rregullohen si trotuare të pavarura për qasje deri te vend varrimi dhe të përshtatshme për kalim për personat me karrocë (hendikep).

### **Neni 14 Nxerrja e varrezave jashtë përdorimit**

1. Kuvendi i Komunës në koordinim me bashkësit fetare me Vendim nxjerr jashtë përdorimit varrezat apo një pjesë të tyre për shkak të mungesës së hapësirës, kushteve sanitare dhe kushteve tjera.
2. Kuvendi i Komunës merr vendim për zhvendosjen e varrezave apo një pjesë të tyre që janë jasht përdorimit, me kusht që zhvendosja dhe varrimi i tyre të sigurohet me ndërtimin e varrezave të reja ose varrezave tjera ekzistuese.

## **Neni 15**

### **Mirëmbajtja**

1. Organi kompetent i administratës (DSHP) administron me punët e varrimit, dhe rregullimit të varrezave në qytet dhe fshatra.
2. Mirëmbajtjen e varrezave në qytetin e Lipjanit, si dhe në të gjitha varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në territorin Komunës i kryen ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar për këtë qëllim.
3. Mirëmbajtjen e varrezave në fshatrat e Komunës së Lipjanit i kryen komuniteti i lokacionit ku gjenden varrezat ose bashkësia fetare përkatëse e atij komuniteti.
4. Rregullimin e varrit mund të bëjnë edhe anëtarët e familjës së të vdekurit sipas kushteve të kësaj Rregulloreje.
5. Të gjitha varret dhe varrezat do të trajtohen me dinjitet nga Komuna, duke respektuar të gjitha konfesionet fetare.
6. Në pajtim me paragrin 5 të këtij neni, pjestarët e të gjitha përkatësive fetare do të kenë qasje të barabartë në ofrimin e shërbimeve komunale, sipas kushteve të parapara me këtë Rregulloreje.

## **Neni 16**

### **Vizitat në varreza**

1. Vizituesit e varrezave janë të detyruar që në varreza të sillen në mënyrën e cila i përgjigjet respektit ndaj të vdekurve dhe me dinjitet në vendet ku ata prehen.
2. Varrezat mund të vizitohen çdo ditë të javës sipas riteve fetare të komuniteteve përkatëse.
3. Në varreza nuk mund të sillen fëmijët deri në moshën 10 vjeçare. Përjashtimisht me përcjelljen e prindërve, personave tjerë të moshuar ose kujdestarit të tij.

## **Neni 17**

### **Ndalesat**

1. Në varreza ndalohet:
  - 1.1. Shkatërrimi me qëllim i vendvarrimeve;
  - 1.2. Shkelja dhe kapërcimi nëpër varre dhe varreza dhe shlyerja tyre;
  - 1.3. Shkaktimi dëmit në varreza ose në shenjat tjera përkujtimore (në përmendore dhe objekte tjera përkujtimore në varreza);
  - 1.4. Prishja e rendit në varreza;
  - 1.5. Thyerja e rrethojave në varreza, dëmtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, drunjëve dhe bimëve tjera të mbjellura në varreza;
  - 1.6. Hyrja në hapësirën e varrezave me automjete private dhe mjete tjera tërheqëse pa pëlqim paraprak;
  - 1.7. Futja e kafshëve;
  - 1.8. Krijimi i papastërtisë në shtigjet dhe në sipërfaqet e gjelbëruara, vendosja ose hedhja e kurorave të vyshkura, luleve të vyshkura ose sendeve tjera;
  - 1.9. Fotografimi pa leje i varrezave për çështje profesionale dhe shpërndarja e fletëpalosjeve;

- 1.10. Ndalohet vendosja e pllakave përkujtimore ose përmendoreve pa kërkesë të veqantë e cila duhet t'i drejtohet organit kompetent komunale duke i bashkangjitur edhe skicën e objektit dhe vërtetimin se është siguruar shfrytëzimi i vendvarrimit;
- 1.11. Hyrja në objektin ku qëndron kufoma dhe objektet tjera jashtë kohës së përcaktuar për varrim, përjashtuar rastet me autorizim të veçantë;
- 1.12. Hedhja e mbeturinave brenda në varreza dhe jashtë varrezave;
- 1.13. Ushtrimi i çdo lloj tregtie;
- 1.14. Pjesëmarrja në zhvarrimin e kufomave që nuk i përkasin familjes, përvëç rasteve kur ka pëlqimin e palëve, që kanë të drejtë sipas autorizimit të veçantë.

**Neni 18**  
**Tabela për sjellje në varreza**

DSHP-ja duhet të vendos tabelen me rregullat e sjelljes në pajtim me nenin 17 të kësaj Rregulloreje në vend të dukshëm në hyrje të varrezave.

**Neni 19**  
**Mënyra e varrimit**

1. Varrimi bëhet në pajtim me dispozitat sanitare, riteve fetare të komuniteteve dhe sipas mënyrës që i përgjigjet të vdekurit, në saje të nderimit të ndjenjave të farefisit dhe të personave tjerë të cilët kanë qenë në afërsi me të vdekurin.
2. Varrimi duhet të bëhet vetëm pasi të jetë konstatuar vdekja e personit.
3. Konstatimin e vdekjes së personit mund ta bëjë mjeku ose Institut i Mjekësisë Ligjore, për raste të caktuara.
4. Varrimi i të vdekurit mund të bëhet edhe në varrezat të cilat i ka caktuar i vdekuri për së gjalli, ose në varrezat që i zgjedhë familja e tij ose personat të cilët kujdesen për varrosjen e tij.

**Neni 20**  
**Djegia e kufomës**

1. Djegia e kufomës ose eshtarve, mund të bëhet vetëm në krematorium.
2. Djegia e kufomës ose eshtrave, bëhet vetëm nëse i vdekuri gjatë jetës së tij ka lënë testament të vleshëm juridikisht që kufoma e tij të digjet.
3. Djegia e kufomes së personit që ka vdekur në mënyrë jo të natyrshme (rrethana të dyshimta), mund të bëhet vetëm pasi të jetë marrë leja nga organet gjyqësore.
4. Hiri i kufomës së djegur duhet të vendoset në enë prej materialit të qëndrueshëm dhe të mbyllur hermetikisht, pastaj mund të mbulohet në varrin e caktuar, ose të vendoset në objektet të caktuar për ruajtje.

**Neni 21**  
**Leja për varrimin**

Leja për varrimin e të vdekurit lëshohet nga Zyra e gjendjes civile e Komunës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**Neni 22**  
**Bartja e kufomës**

Bartja e kufomave deri te varrezat do të bëhet nga vetë komuniteti përkatës i lokalitetit sipas rregullave të riteve fetare të tyre.

**Neni 23**  
**Nderimet për të vdekurin**

1. Dhënia e nderimit të fundit (të pasvdekjes) mund të bëhet në hapësirën e përcaktuar në vend-varreza ose në objektet përkatëse fetare.
2. Para varrimit, kufomat e heronjve, dëshmorëve dhe personave tjerë me merita të veçanta, mund të vendosen në vendin e caktuar jashtë varrezave me qëllim të dhënes së nderimit të veçantë të pasvdekjes, nëse organizimi i varrimit bëhet nga organet komunale ose organet qendrore të shtetit.

**Neni 24**  
**Koha për shërbimet e varrimit**

1. Veprimtaria e varrimit do të organizohet nga bashkësítë fetare të komunitetit përkatës të cilat janë të obliguara që për varrimin e të vdekurve të sigurojnë shërbime të përditshme, duke përfshirë edhe të dielat dhe festat zyrtare si vijon:
  - 1.1. Prej 1 majit deri me 30 shtator prej orës 8 deri në orën 20:00.
  - 1.2. Prej 1 tetorit deri më 30 prill prej orës 8 deri në ora 19:00.

**Neni 25**  
**Zhvarrosja e kufomave**

1. Me pëlqimin apo vendimin e organit kompetent komunal gjegjësisht inspeksionit sanitar në prani të policisë së Kosovës, mund të bëhet zhvarrosja (nxjerrja) e mbetjeve të kufomës për t'u bartur – rivarrosur në një vend-varrezë tjetër ose për çështje tjera (ekshumacionin e kufomave).
2. Lidhur me pikën 1 të këtij nenit mbahet procesverbal i nganjëherës së organit kompetent ose personit tjetër të autorizuar për këtë çështje dhe i nënshkruar nga palët.
3. Shpenzimet lidhur me punën rreth zhvendosjes dhe çështjeve tjera (ekshumacionin e kufomave) bien në barrë të vetë atij i cili ka kërkuar zhvendosjen e mbetjeve të kufomës ose për çështje tjera (ekshumacionin).

**Neni 26**  
**Mbikëqyrja dhe zbatimi i Rregullores**

1. Mbikëqyrjen në zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje e bënë Drejtoreti për Shërbime Publike dhe Drejtoreti për Inspektorat.
2. Inspektoret sanitar gjatë mbikëqyrjes mund të marrin masa dhe të urdhërojnë marrjen ose mos marrjen e një veprimi të caktuar, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe dispozitat e aplikueshme të ligjit.

3. Në vendimin e inspektorit mund të ushtrohet ankesa në afatin prej 8 ditësh nga dita e njoftimit, drejtuar Inspektoratit Sanitar të Kosoves.

## II. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 27  
Gjobat

1. Për të gjitha veprimet e kundërligjore në varreza do të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.
2. Për shkelje të nenit 17 do të dënohen me gjobë:
  - 2.1. Për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik në shumën prej 10€ - 100€.
  - 2.2. Për personin fizik që ushtron biznes individual prej 30€ - 250€.
  - 2.3. Për personin juridik prej 100€ - 1500€.

## III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 28  
Dispozitat kalimtare

1. Çdo dispozitë e kësaj Rregulloreje që bie ndesh me ligjet në fuqi epërsi do të kenë dispozitat ligjore.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për varrezat 1Nr.512-192 e datës 21.07.2006.

Neni 29  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës dhe fillon të zbatohet nga 01.01.2019.

15Nr. 011 - 71878

Lipjan, më 27. 11. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

